

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6821
E enjte, 9 shkurt 2023
çmimi 0.40 €

Ndarja e brendshme
e Kosovës, një Zajebnicë
dhe disa asociacione | FAQE 2

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RASTI I LIDERËVE TË UÇK-së, TRUPI GJYKUES: ZPS-ja DËSHTOI T'I SHPALOSË ME KOHË DËSHMITË SHFAJËSUESE

FAQE 4-5



Pas kërkesës së mbrojtjes së liderëve të UÇK-së, trupi gjykues i Gjykatës Speciale ka konstatuar se

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka dështuar t'i përmbushë plotësisht detyrimet e saj për

zbulim në përputhje me Rregullën 103 në lidhje me kategori të caktuara të dokumenteve

30 DITË AKTIVITETE PËR 15-VJETORIN E PAVARËSISË DHE 25-VJETORIN E EPOPESË SË UÇK-së



EPOPEJA E
USHTRISË
ÇLIRIMTARE TË
KOSOVËS
përfjetë



MBI 11 200 VIKTIMA
NGA TËRMETET NË
TURQI DHE SIRI | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

MOSFATURIMI I ENERGJISË NË VERI,
BISLIMI FAJËSON BRUKSELIN | F. 8

KUVENDI NUK E MIRATON RAPORTIN
VJETOR TË BQK-së | F. 8

SPORT



VDES LEGJENDA E KROACISË
DHE E PRISHTINËS | F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni: ShBA-ja është e vetmja që del më e fortë nga krizat

WASHINGTON, 8 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka përshëndetur rimëkëmbjen e ekonomisë amerikane dhe krijimin e, siç ka thënë, 12 milionë vendeve të reja të punës. Në një fjalim drejtuar kombit, Bideni tha se ShBA-ja është vendi i vetëm në botë që del "më i fortë" nga krizat. "Sot [pandemia] Covid-19 nuk e kontrollon më jetën tonë. Dy vjet më parë demokracia jonë është përballur me kërcënimin më të madh që nga lufta civile. Sot, edhe pse nën sulm, demokracia jonë mbetet e palëkundur dhe e pathyeshme", ka thënë ai. Presidenti amerikan tha se në dy

vjetët e fundit administrata e tij ka arritur "të krijojë një rekord prej 12 milionë vendesh të reja pune". Këtë, sipas tij, nuk e ka arritur asnjë president tjetër as brenda mandatit katërvjeçar. "Plani im ekonomik ka të bëjë me investimet në vende dhe njerëz që janë harruar. Mes trazirave ekonomike të katër dekadave të fundit, shumë njerëz janë lënë pas ose janë trajtuar si të padukshëm", ka theksuar Bideni, duke shtuar se ShBA-ja po ndërton një ekonomi ku askush nuk mbetet prapa. "Biznesi po kthehet. Krenaria po kthehet për shkak të zgjedhjeve që kemi bërë gjatë viteve të fundit", ka deklaruar Bideni.



Bullgaria akuzohet për keqtrajtim të migrantëve

SOFJE, 8 SHKURT - Bullgaria po përballlet me akuzat të shumta se po abuzon njerëzit që po tentojnë ta kalojnë kufirin e saj me Turqinë teksa azilkërkuesit kanë thënë se ata janë kthyer mbrapsht, janë arrestuar, kontrolluar dhe janë rrahur.

Ky shtet i Bashkimit Evropian shërben si portë për të hyrë në bllokun evropian dhe po tenton t'i forcojë kontrollat kufitare me qëllim që ta ndalë numrin në rritje të personave që po tentojnë ta kalojnë kufirin. Numri i kalimeve kufitare ka arritur në nivele që nuk janë parë që nga viti 2015. "Që nga fillimi i vitit të kaluar ne kemi parë një kthim intensiv dhe brutal të njerëzve", një praktikë që është e paligjshme në BE, tha Diana Dimova, udhëheqëse e grupit për ndihmën e refugjatëve në Bullgari, Mission Wings.

Sipas dëshmimeve të azilkërkuesve dhe raporteve të agjencisë evropiane për kufijtë, "Frontex", thuhet se Bullgaria përdor metoda



brutale ndaj personave që tentojnë ta kalojnë kufirin. Policia kufitare ka penguar 164 000 "kalime ilegale" të kufirit më 2022, krahasuar me 55 000 përpjekje më 2021, ka thënë Ministria e Brendshme e Bullgarisë, raporton

Rel. Rritja e numrit të personave që tentojnë të hyjnë në Bullgari veçse ka ndikuar që Austria dhe Holanda ta bllokojnë përpjekjen e Sofjes që të bëhet anëtare e zonës Schengen.

Në përpjekje për ta ndaluar fluksin e kalimeve ilegale, autoritetet bullgare kanë shtuar kontrollat në kufirin prej 234-kilometrash me Turqinë, i cili është pothuajse i tëri i rrethuar me tela me gjemba. Disa medie evropiane në fundin e

vitit të kaluar, së bashku me një organizatë për të drejtat e njeriut, dokumentuan abuzimet ndaj azilkërkuesve.

Ndërkaq, "Frontex" ka thënë se janë regjistruar 25 "incidente serioze" që lidhen me aktivitetet e Bullgarisë në vitin 2021 dhe 2022. "Kthimi mbrapsht i personave ndodh shpesh në zonën operacionale dhe stafi i 'Frontex' qëllimisht mbahet larg kur autoritetet veprojnë kështu", thuhet në raportin e "Frontex"-it të cilin e ka parë AFP-ja. Në këtë raport, po ashtu, thuhet se autoritetet përdorin gjuhë denigruese dhe raciste, duke iu referuar migrantëve me termin "talibanë".

Autoritetet bullgare vazhdimisht kanë mohuar akuzat për abuzim. Sofja, po ashtu, ka kërkuar nga BE-ja 2 miliardë euro për t'i forcuar rrethojat kufitare dhe për ta përmirësuar vëzhgimin, por deri më tani Brukseli ka refuzuar që t'i ndajë këto fonde.

Inteligjencia amerikane insiston se balona e rrëzuar ishte e ushtrisë kineze

WASHINGTON, 8 SHKURT - Burimet e inteligjencës amerikane kanë insistuar se balona që rrëzuan të shtunën ishte përdorur nga ushtria kineze për spiunim. Zyrtarë të paidentifikuar i thanë "Washington Post" se besojnë se balona të tillë janë përdorur për të mbledhur informacione të inteligjencës dhe strategjike në territoret e rëndësishme. Aty përfshihen Japonia, India, Tajvani dhe Filipinet.

Zyrtarët kinezë veçse kanë mohuar se përdorin balona të tillë për vëzhgim.

Një zyrtar i tha "Washington Post"-it se komuniteti amerikan i inteligjencës beson se disa prej balonave ishin nisur nga Hainan,

një ishull kinez ku gjendet një bazë ushtarake detare.

Duke cituar një zyrtar të lartë, të paidentifikuar, të administratës të presidentit amerikan, Joe Biden, "CBS News" ka konfirmuar se komuniteti i inteligjencës në ShBA beson se balona ishte pjesë e "programit të vëzhgimit që udhëhiqet nga Ushtria për Çlirimin e Popullit në Hainan".

Të hënën ShBA-ja informoi 40 shtete aleate lidhur me spiunazhin e supozuar, konfirmoi një zyrtar i administratës amerikane për "CBS News".

Zbulimi i balonave, që dyshohet se përdoren për spiunazh, shkaktoi tensione diplomatike



midis ShBA-së dhe Kinës. Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, shtyu vizitën e

planifikuar për Pekin, që ishte paraparë të ndodhte disa ditë pasi u zbulua balona e parë. Ky do

të ishte udhëtimi i parë i një kryediplomati amerikan në Kinë për shumë vjet.

Mbi 11 200 viktima nga tërmetet në Turqi dhe Siri

8 574 persona janë konfirmuar të vdekur në Turqi dhe 2 662 në Siri. Numri i viktimave pritet të rritet teksa ekipet e shpëtimit vazhdojnë të kërkojnë të mbijetuar të tërmeteve të fuqishme

ANKARA, 8 SHKURT - Në Turqi dhe Siri, si pasojë e tërmeteve të fuqishme të 6 shkurtit, kanë humbur jetën mbi 11 200 persona. Zyrtarët thanë më 8 shkurt se 8 574 persona janë konfirmuar të vdekur në Turqi dhe 2 662 në Siri. Numri i viktimave pritet të rritet teksa ekipet e shpëtimit vazhdojnë të kërkojnë të mbijetuar të tërmeteve të fuqishme.

Tërmeti i parë i 6 shkurtit ishte 7.8 ballësh me epiqendrë rreth 26 kilometra nga qyteti Nurdagi dhe rreth 33 kilometra larg qytetit Gaziantep, tha Shërbimi Gjeologjik amerikan. Po ashtu, gjatë po asaj dite u regjistrua një tërmet tjetër i fuqishëm prej 7.5-shkallësh të Rihterit. Por, përpjekjet e shpëtimit janë penguar nga temperaturat e ulëta dhe qindra pasgoditje, të cilat e kanë bërë veçanërisht të rrezikshme punën në strukturat e paqëndrueshme.

Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, e pranoi se ka pasur probleme në përgjigjen fillestare ndaj tërmeteve masive.

Duke folur për gazetarët në Kahramanmarash më 8 shkurt, rajon që gjendet afër

epiqendrës së tërmetit, Erdogan tha se ka pasur probleme me rrugët dhe aeroportet, por shtoi se tani gjërat po përmirësohen ditë-ditë.

Presidenti turk tha se qytetarët duhet të komunikojnë vetëm me autoritetet dhe t'i inorojnë "provokatorët" teksa mijëra persona janë ankuar se ka mungesë të burimeve dhe i kanë kritikuar zyrtarët për përgjigje të ngadalshme ndaj kësaj fatkeqësie natyrore.

Ndërkaq, në qytetin sirian të Xhindajrisit, një foshnjë e sapolindur u nxor nga rrënojat. "Ne pastruam pluhurin dhe e gjetëm foshnjën që kishte ende kordonin e kërthizës, e premë atë dhe kushëriri im e mori foshnjën e dërgoi në spital", tha një familjar i foshnjës së shpëtuar nga rrënojat.

Disa prej dëmeve më të mëdha janë regjistruar në provincën turke të Gaziantepit, ku qindra ndërtesa janë shembur dhe janë bllokuar rrugët, duke penguar përpjekjet e shpëtimit.

Personat që i kanë mbijetuar tërmetit, shumica prej të cilëve nuk kanë këpucë e as rroba të



ngrohta, po përballen me mbijetesë në temperatura të ulëta.

Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, pritet që ta vizitojë zonën e prekur nga tërmetet më 8 shkurt. "Kjo është një prej fatkeqësive më të mëdha në rajonin tonë dhe në botë, jo vetëm në historinë e republikës sonë", tha ai.

Në Siri, operacionet e shpëtimit janë ndërlikuar për shkak se sistemi i kujdesit shëndetësor dhe infrastruktura është shkatërruar nga lufta civile që po zgjat që 12 vjet.

Dhjetëra shtete në mbarë

botën kanë ofruar ndihmë emergjente humanitare, përfshirë dërgimin e ekipeve të kërkimshpëtimit dhe furnizime të tjera të ndihmës. Ministri i Punëve të Jashtme i Turqisë, Mevlut Cavusoglu, tha se ekipet nga 35 shtete tashmë kanë arritur në zonat e prekura nga tërmetet.

Bashkimi Evropian ka ofruar që të dërgojë mbi 1 200 punëtorë të shpëtimit, përfshirë dy ekipe mjekësore dhe mbi 70 qen të kërkim-shpëtimit.

Organizata Botërore e Shëndetësisë tha se deri në 23 milionë persona mund të

preken nga fatkeqësia, ndërkaq Gjysmëhëna e Kuqe siriane bëri thirrje që komuniteti ndërkombëtar t'i heqë sanksionet e vendosura ndaj Qeverisë së presidentit autoritar sirian, Bashar al-Assad, për t'i lehtësuar përpjekjet e shpëtimit.

Tërmeti prej 7.8 ballësh ishte më i fuqishmi që ka goditur Turqinë që nga viti 1939, kur 33 000 persona u vranë në provincën Erzincan. Mbi 17 000 persona u vranë më 1999 nga tërmeti në këtë zonë, që është një prej zonave me aktivitet më të madh sizmik në botë.

30 ditë aktivitete për 15-vjetorin e Pavarësisë dhe 25-vjetorin e Epopesë së UÇK-së



EPOPEJA E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

përvjetë.

PRISHINË, 8 SHKURT (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, i shoqëruar edhe nga zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, ka paraqitur të mërkurën Agjendën Shtetërore për 15-vjetorin e Pavarësisë dhe 25-vjetorin e Epopesë së UÇK-së. Në

konferencën për medie, Çeku, duke paraqitur programin shtetëror për këto dy data jubile, ka theksuar se ky program i përbashkët fillon më 9 shkurt dhe përfundon më 12 mars.

Ky program 30-ditor përfshin aktivitete të ndryshme: Do të ketë

homazhe, nderime, parakalim i Forcës së Sigurisë së Kosovës, turne kampionate në sport, aktivitete muzikore, shfaqje filmi, teatri, baleti, ekspozita, promovime librash, gara shkollore e sesione shkencore.

Gjithashtu, do të ketë shumë pritje

shtetërore që organizohen nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe në të gjitha përfaqësitë diplomatike të Kosovës nëpër botë. Në 43 Ambasada, Konsullata dhe në Zyra Ndërlidhëse të Republikës së Kosovës do të ketë pritje

shtetërore, që do të shoqërohen me nga një ngjarje muzikore ku do të performojnë artistët e Kosovës. Për shënimin e këtyre dy datave jubile, Këshilli Organizativ do të përkujdeset që për 30 ditë t'i publikojë detajet e aktiviteteve ditore.



Rasti i liderëve të UÇK-së, trupi gjykues: ZPS-ja dështoi t'i shpalosë me kohë dëshmitë shfajësuese

Pas kërkesës së mbrojtjes së liderëve të UÇK-së, trupi gjykues i Gjykatës Speciale ka konstatuar se Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka dështuar t'i përmbushë plotësisht detyrimet e saj për zbulim në përputhje me Rregullën 103 në lidhje me kategori të caktuara të dokumenteve. Sipas vendimit, duke marrë parasysh rolin kryesor të zbulimit në kohë, në veçanti në lidhje me materialin shfajësues, paneli është i mendimit se dështimi i zbulimit nga ana e ZPS-së plotëson pragun e mospërputhjes, sipas kuptimit të Rregullës 110 të Rregullave, dhe kështu garanton miratimin e “masave të duhura”

HAGË, 8 SHKURT - Trupi gjykues në rastin e drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të cilët ka më shumë se dy vjet që po mbahen në paraburgim në Hagë, ka zbuluar edhe një lojë të pistë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Trupi gjykues në rastin ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Kadri Veseli e Jakup Krasniqi dhe ish-shefit të deputetëve të Vetëvendosjes, Rexhep Selimi, gjykim që pritet të nisë më 1 mars të këtij viti, ka konstatuar se ZPS-ja ka dështuar t'i shpalosë dëshmitë shfajësuese me kohë. “Trupi gjykues është i mendimit se, më shumë se dy vjet pas arrestimit të të akuzuarve dhe nisjes së gjykimit pas më pak se 40 ditë, konteksti i procedurës nuk e arsyeton më zbulimin e vonuar të

provave shfajësuese për mbrojtjen. Paneli, gjithashtu, rithekson se detyrimi i prokurorisë për t'ia zbuluar këtë lloj informacioni mbrojtjes është po aq i rëndësishëm sa edhe detyrimi për të ndjekur penalisht”, ka konstatuar paneli i trupi gjykues. Po ashtu, ky panel ka konstatuar se ZPS-ja nuk i ka arsyetuar në mënyrë adekuate vonesat për shpalosjen e materialit në fjalë. “Në veçanti, fakti që detyrimi për dhënien e informacioneve shfajësuese bazuar në Rregullën 103 është i vazhdueshëm ose ‘i përsëritur’ nuk mund t'i justifikojë ato vonesa. Rregulla 103 kërkon që një material i tillë të shpaloset ‘menjëherë’, që do të thotë posa ai të jetë në posedim të

prokurorisë dhe pa vonesë të panevojshme”, ka konstatuar paneli gjykues i Gjykatës Speciale. Prokuroria është urdhëruar t'i trajtojë detyrimet e saj për shpalosjen e materialeve si prioritet që kërkon kohë dhe resurse në përpjesëtim me rëndësinë e saj. “ZPS-ja urdhërohet të zbatojë një përkufizim të gjerë të detyrimeve të saj për shpalosjen e materialeve shfajësuese, sipas Rregullës 103, siç përshkruhet më lart në pikën 29”, ka konstatuar trupi gjykues i Speciales. Gjithashtu, sipas tyre, çdo kërkesë e mbrojtjes për ta shtyrë dëshminë e dëshmitarëve të prokurorisë, materiali dëshmues i të cilëve u shpalos ose do të shpaloset me vonesë, do të merret parasysh nga paneli në rastet kur shpalosja e vonuar e materialit përkatës ka ndikuar dukshëm në mundësinë e mbrojtjes për t'u përgatitur në mënyrë efektive.

Më 1 mars protestë në Hagë: Nuk kemi heronj për të sakrifikuar

Me iniciativë të disa bashkatdhetarëve që jetojnë e veprojnë në vende të ndryshme të Evropës, do të mbahet protestë kundër, sipas tyre, kundër gjykimit

të heronjve të luftës dhe paqes, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Kjo protestë do të mbahet më 1 mars në Hagë. “Ne nuk kemi heronj për të sakrifikuar, prandaj më 1 mars protestojmë në Hagë. Të protestojmë kundër kësaj padrejtësie speciale ndaj UÇK-së. Le t'i tregojmë botës që s'kemi asgjë më të shtrenjtë se UÇK-në dhe lirinë. Le të protestojmë të bashkuar për të vërtetën dhe drejtësinë! Shqiptarë, kudo që jeni, bashkohuni për të protestuar! Gjykimi i heronjve tanë të luftës dhe paqes, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, fillon më 1 mars 2023. Ne nuk kemi heronj për të sakrifikuar, prandaj më 1 mars protestojmë në Hagë. Të protestojmë kundër kësaj padrejtësie speciale ndaj UÇK-së. Le t'i tregojmë botës që s'kemi asgjë më të shtrenjtë se UÇK-në dhe lirinë. Le të protestojmë të bashkuar për të vërtetën dhe drejtësinë! Diasporë, ju që asnjëherë nuk kursyet për atdheun, bashkohuni dhe ejani më 1 mars 2023, nga 09:00h-12:00h, për të protestuar në rrugën ‘Laan van Reagan en Gorbatsjov’, Den Haag, Nederlande. Protestoni për UÇK-në, për ata që i mbrojtën familjet dhe popullin tonë!”, është thënë në ftesën për protestë.

Refuzohet kërkesa e mbrojtjes së Thaçit lidhur me nëntë dëshmitarët diplomatë

Trupi gjykues i kryesuar nga Charles L. Smith II ka refuzuar kërkesën e mbrojtjes së ish-presidentit Hashim Thaçi lidhur me nëntë dëshmitarët diplomatë. Mbrojtja kishte kërkuar t'i ruajë provat e nëntë dëshmitarëve, për të garantuar të drejtën e Thaçit për të siguruar pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij, në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij, raporton “Betimi për Drejtësi”. “Për ta bërë këtë, mbrojtja i kërkon Panelit që ta ndryshojë rendin e zakonshëm të provave, siç parashikohet në rregullën 127, në mënyrë që të dëgjojë dëshmitë e dëshmitarëve përpara fillimit të çështjes së ZPS-së, në vend pas përfundimit të saj. Në alternativë, mbrojtja fton Panelin që të sigurojë dëshmitë e dëshmitarëve duke vëzhguar marrjen e deponitave sipas Rregullës 100”, është thënë në vendim të gjykatës. Mbrojtja e Thaçit kishte pohuar se kuadri ligjor i Gjykatës Speciale e autorizon panelin të miratojë një kërkesë për ruajtjen e provave përmes deponitave nëse ka arsye për të besuar se provat e një dëshmitari të mundshëm mund

të bëhen të padisponueshme. “Mbrojtja pohon se dëshmitarët do të ofrojnë disa nga provat më të rëndësishme që DhSK-ja do të dëgjojë në këtë rast, ndër të tjera, për shkak të: (i) pozitës dhe roleve të tyre në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës; (ii) përparësi unike dhe përfshirje me individë kyç gjatë asaj kohe; (iii) ndërveprimet me z. Thaçi në nivel profesional dhe, në disa raste, personal; dhe (iv) aftësia për të dëshmuar për çështje thelbësore për rastin”, është thënë në vendim. Sipas vendimit, mbrojtja ka pohuar se mocioni është i justifikuar në dritën e dy faktorëve: moshë e shtyrë e dëshmitarëve dhe koha e parashikuar kur mbrojtja ka të ngjarë të fillojë çështjen në dritën e parashikimeve aktuale, domethënë në fund të vitit 2025 ose në fillim të vitit 2026. Më tutje, në vendim është thënë se në kohën kur fillon çështja e mbrojtjes, ekziston një rrezik shumë real që dëshmitarët e dëshmitarëve, të cilët më pas do të jenë në të ’80-at, mund të mos jenë më të disponueshme për shkak të vdekjes ose paafetësisë. “Sa i përket procedurës së ndihmës parësore, mbrojtja kërkon që dëshmitarët të dëgohen në sallën e gjyqit të DhSK në mars 2023, por për një që është i disponueshëm vetëm që nga prilli 2023. Sa i përket ndihmës alternative, ajo kërkon që depozitimet të kryhen në seancë të hapur në sallën e gjyqit të DhSK, nëse dëshmitarët janë mjaft mirë për të udhëtuar në shkurt 2023, me përjashtim të një dëshmitari të disponueshëm në prill 2023”, është thënë në këtë vendim. Lidhur me këtë mocion, Zyra e



Prokurorit të Specializuar (ZPS) kishte kërkuar që i njëjti të refuzohet nga ana e trupit gjykues.

Mbrojtja e Selimit i bashkohet Thaçit në kërkesën për zvogëlimin e periudhës kohore të aktakuzës

Mbrojtja e Rexhep Selimit i është bashkuar kërkesës së mbrojtjes së Hashim Thaçit për zvogëlim të periudhës kohore të aktakuzës. Ndryshe, mbrojtja e Hashim Thaçit ka bërë kërkesë që trupi gjykues ta ftojë Zyrën e Prokurorit të Specializuar që ta ngushtojë shtrirjen kohore të aktakuzës, në jo më vonë se 20 qershori i vitit 1999, raporton “Betimi për Drejtësi”. “Për më tepër, siç parashtrohet më poshtë, trupi gjykues tashmë ka informacion të mjaftueshëm përpara tij për të

konkluduar se provat e ofruara nga ZPS për ta mbështetur pretendimin për ekzistencën e konfliktit të armatosur në Kosovë pas datës 20 qershor 1999 do të jenë të pamjaftueshme për të ‘mbështetur një dënim përtej dyshimit të arsyeshëm’ (standardi në Rregullin 130 (3) të Rregullave) për krimet e luftës përtej asaj date”, është thënë në kërkesën e mbrojtjes. Mbrojtja ka argumentuar se

konflikti i armatosur në Kosovë ka përfunduar jo më vonë se 20 qershor 1999, datë e nënshkrimit të çmilitarizimit dhe transformimit të UÇK-së. Mbrojtja, ndër të tjera, mbështetet në konkluzionet e disa gjykatave vendase dhe ndërkombëtare, duke përfshirë Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë se konflikti i armatosur në Kosovë ka përfunduar jo më vonë se qershori 1999.

Pjetër Shalës i vazhdohet paraburgimi

Trupi gjykues i kryesuar nga Mappie Veldt-Foglia ka marrë vendim, me anë të të cilit, Pjetër Shalës i është vazhduar masa e paraburgimit. Trupi gjykues ka arritur në konkludim se ekzistojnë arsye që rreziku i pengimit të ecurisë së procedurave të Gjykatës Speciale dhe rreziku i kryerjes së “krimeve” të mëtejshme, vazhdon të ekzistojë. Ndryshe, Shala është arrestuar më 16 mars 2021, nga autoritetet belge dhe është transferuar në Hagë më 15 prill 2021, në bazë të një kërkesë për bashkëpunim në zbatimin e fletarrestimit dhe urdhrin për transferim lëshuar nga Gjykata Speciale.

Prokuroria kërkon që Thaçit dhe Veselit t’i vazhdohet masa e paraburgimit

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka kërkuar që ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe ish-kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli, t’i vazhdohet masa e paraburgimit. Gjyqtari i procedurës paraprake dhe Gjykata e Apelit kanë deklaruar në mënyrë të përsëritur se paraburgimi i Veselit është i arsyetuar në baza të shumëfishta, se asnjë kusht i shkurtër i paraburgimit në objektet e paraburgimit të Dhomës së Specializuar të Kosovës (DhSK) s’do të ishte i mjaftueshëm për t’i minimizuar rreziqet dhe se periudha e paraburgimit, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante është e arsyeshme”, është thënë në kërkesën e ZPS-së. Sipas ZPS-së, nga përcaktimi i fundit i këtij paneli më 19 dhjetor 2022, nuk ka pasur asnjë ndryshim në rrethanat që devijojnë nga ai përcaktim. “Në të vërtetë, transferimi i çështjes në panel, caktimi i datës së gjykimit dhe zhvillimeve të tjera të rëndësishme që tregojnë progres të qëndrueshëm dhe do t’i japin Veselit qasje të mëtejme në informacione në lidhje me dëshmitarët e ndjeshëm dhe rastin kundër tij, mbështetin domosdoshmërinë dhe arsyeshmërinë e paraburgimit”, ka theksuar SPS-ja. Veseli së bashku me Hashim Thaçin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin është duke u mbajtur në qendrën e paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020.



Ndarja e brendshme e Kosovës, një Zajebnicë dhe disa asociacione



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Kosovën e japim, Serbinë jo: Jo fort moti rugët dhe sheshet e Prishtinës dhe qyteteve tjera të Kosovës mbusheshin me protestues në mbrojtje të Republikës së Dytë, si pararendëse e një Republike të Tretë që aktualisht po kalon nëpër vuajtjet e Tantalit e që po duan ta shtrijnë në Shtratin e Prokrustit. Shkak dhe pasojë është Asociacioni i Komunave me shumicë serbe (emërtim zyrtar) ndërsa LV-ja e pati quajtur Zajednicë kurse unë e korrigoja gjuhësisht duke e quajtur Zajebnicë. Nëse e kemi parasysh qëllimin e Serbisë e që tani duket se është bërë edhe qëllim i ndërkombëtarëve atëherë duket se jemi në një rrugë njëkahëshe, pa asnjë shtegdalje përveç formimit të këtij mekanizmi parashtetëror. Realisht në vitin 2013 ishte arritur një marrëveshje në Bruksel për themelimin e Asociacionit - Zajebnicës e që ishte ratifikuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2015 me 2/3 e deputetëve, siç parashihet për një marrëveshje ndërkombëtare. Gjykata Kushtetuese e Kosovës kishte gjetur shkelje në 22 pika që ishin në kundërshtim me Kushtetutën por se kishte rekomanduar që të vazhdohet me formimin e Zajebnicës. Kjo tregon se Gjykata Kushtetuese nuk ka kapacitet e as kompetencë të ndalojë formimin e Zajebnicës për faktin se çdo marrëveshje ndërkombëtare është mbi Gjykatën Kushtetuese dhe të gjitha përpjekjet që bëhen sot janë lojëra sepse Zajebnica megjithatë, po kalon. Serbia nuk është e gatshme ta pranojë që të bisedohet për një marrëveshje që e ka kapacitetin e një marrëveshjeje Ndërkombëtare aq më parë që Zajebnicën e konsideron si "Dhurat Hyjnore" për ta përligjur praninë, ndikimin dhe vendimmarrjen për çështje të brendshme të Kosovës e që është në kundërshtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare. Ata që e kanë pranuar Zajebnicën, si kushtëzim të ndërkombëtarëve dhe që i kanë hapur derën e madhe për një Ahtisari plus, është dashur edhe ta formojnë Zajebnicën mirëpo nuk ishte bërë asnjë propozim për tekstin e statutit dhe dokumenteve tjera përcjellëse me të cilat do të përcaktohej fushëveprimi dhe

kompetencat e këtij mekanizmi që na ka shkaktuar dhe po na shkakton shumë probleme, si në planin e brendshëm, duke shkaktuar shumë përçarje midis shqiptarëve dhe subjekteve politike ashtu edhe në planin e jashtëm duke e kushtëzuar presionin e faktorit vendimmarrës ndërkombëtar, tash të sforcuar edhe me një propozim që e vë Kosovën në vdekje klinike politike dhe institucionale sikur që është propozimi franko-gjerman, i njëjtësuar si propozim evropian dhe i përkrahur edhe nga ShBA-të. LV-ja, krejt fushatën elektorale e ka ndërtuar kundër Zajebnicës dhe marrëveshjeve tjera të Brukselit për të cilat ishte një zotim publik se do të rishikohen dhe se nuk do të pranohen. Për të arritur këto qëllime kërkohet mbi 50 për qind të votave sepse, në të kundërtën nuk do të kishin mundësi të realizojnë premtimet elektorale. Në emër të Zajebnicës dhe kundër Zajebnicës ka pasur protestues të ekzekutuar, shumë të plagosur, arrestime të shumta të protestuesve, dhunë ndaj protestuesve, arrestime dhe dënime të shqiptuara sikur që ishte ushtruar një dhunë jonormale, e paarsyeshme dhe kundër çdo logjike ndaj policëve të Policisë së Kosovës të cilët, maksimalisht tregoheshin të matur dhe të rezervuar ndaj protestuesve, si gjatë protestave e në veçanti në kohën kur ishin të privuar nga liria. Në anën tjetër protestuesit nuk ushtronin asnjë dhunë ndaj policëve ndërkombëtarë, qoftë se nuk kishin guxim apo ndonjë qëllim tjetër. Ishin raste të rralla kur policët e Kosovës ushtruan dhunë ndaj protestuesve madje në shumë raste, më mirë janë sjell policët kosovarë ndaj demonstruesve, se demonstruesit ndaj policëve. Isha dëshmitar në, së paku 90 për qind të rasteve ku përballeshin policët me demonstrues dhe i kam vizituar thuaja të gjithë të privuarit nga liria gjatë shtatë ditëve të javë në orarin 24 orësh, pa u penguar asnjëherë nga policët apo stafi mbajtës dhe korrektues.

Zajebnica me shumë emra, si kuçedra me shumë kokë: LV-ja, sidomos udhëheqësit e saj në Prishtinë dhe Grupi Anarkist në Tiranë që, për dallim nga Grupi Anarkist i Shkodrës nuk kanë, as guxim e as koçë të përballen edhe me rrezikun më të vogël, ushqyen pritje shumë të mëdha te anëtarësia dhe votuesit e të gjitha subjekteve tjera politike, të pakënaqur me gjendjen sikur edhe me të papërcaktuarit, se, me të ardhur në pushtet, FSK-ja do të bëhet ushtri dhe do të dërgohet në veri të Kosovës, se

Policia e Kosovës të cilën aq pamëshirshëm e rrahën, e fyen dhe poshtëruan pikërisht këta që janë sot në pushtet do t'i çbëjë strukturat paralele, se Marrëveshjet e Brukselit do të vendosen në arkiva e se Zajebnica do të mbetet vetëm shprehje gjuhësore, pa asnjë mundësi të zbatimit, se nuk bisedojnë asnjëherë me Serbinë dhe Vuçiqin pa kërkuar falje, se nuk do të ulen për bisedime pa zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, se nepotizmin dhe punësimet familjare do t'i lënë për syneti, kanaxheq, dasme e ahengje të tjera se do ta padisin Serbinë për gjenocid e shumë e shumë premtime që, sa të jeni në opozitë nuk nxisin asnjë përgjegjësi ligjore kurse përgjegjësia morale në Kosovë është e pranishme sa edhe dinosaurët e epokës së gurit. Është e qartë se sa ishin në opozitë, LV-ja nuk kishte informata të mjaftueshme për gjendjen reale kurse, sa e mori pushtetin, jotransparencën e bëri simbol identifikues duke mbyllur burimet e informatave apo duke shpërndarë informata glorifikues, si në Korenë e Veriut apo duke informuar anëtarësinë sikur në kohën e Revolucionit kinez, me deci bao, gazeta muri kur njëri (i besuari i partisë lexon përmbytjen kurse anëtarësia vetëm dëgjon fjalët dhe mësimet e liderit dhe Mësuesit të Madh duke aplauduar, pa asnjë kundërshtim). Kështu disiplinohen masat ndërsa të pabindurit drejt e në gulag apo, si dënim më i butë, linçim moral publik përmes jeniçerëve kujdestarë të rrjeteve sociale. Nëse më herët na kanë konsideruar si idiotë, tash po bëjnë përpjekje të na trajtojnë sipas asaj si na kanë konsideruar, idiotë e shkuar idiotëve! Tash, Zajebnicën, nga një distancë e sigurt po e kundërshtojnë, deri në kolën e fundit apo salmonin e fundit të tymosur dhe të patymosur, pasardhësit, pa bythë, pa koç... dhe pa guxim të Vojo Kushit, Sadik Premtes, Sadik Stavileci, Anastas Lulos dhe të tjerëve, duke kërkuar të flijohemi edhe kundër Vuçiqit, Putinit, Sholcit, zonzjës Makron e deri edhe të Xhoe Bajden. Këta nuk i llogarisin as si mikrofaktorë Eskobarin, Cholletin, Blinkenin, rencin dhe mashtruesin Lajçak sikur edhe Rrahman Morinën e Katalonjës, Josef Borrell. Në anën tjetër, vetëm gjumi po i ndanë kryeministrin Kurti dhe ajnshtajnin negociues nga Muçibaba, Nik Limin, aq shumë janë të lidhur, madje edhe drekat dhe darkat po i fillojnë me himnin: "treth drekave dhe darkave të përbashkuar, me një dëshirë, me një qëllim, se Zajebnicën e kemi pranuar, me

të njëjtën përmbajtje por me një tjetër emërtim...". Realisht, të gjithë po garantojnë, përmes deklaratave publike por jo edhe të nënshkruar në letër se nuk do të lejohet një Republika Srpska e Bosnjës në Kosovë. Në rregull por unë i kam rezervat e mia, jam shumë mosbesues! Nuk jam pjesë e institucioneve prandaj e kam këtë mundësi dhe komoditet, sikur kur LV-ja ishte në opozitë. Po të isha në pushtet, sigurisht se do ta këndoja këngën, jo Zajebnica nuk kalon por këngën e Lajçakut, Borrellit dhe Eskobarit se Asociacioni ka kaluar. Ne shqiptarët që dikur ishim patriotë kurse sot jemi patriotë folklorikë, polifoninë e kemi shumë të dashur prandaj, nga kjo pozitë, besoj se edhe Albin Kurti dhe LV-ja bashkë me presidenten po vazhdojnë ta këndojnë se Zajebnica nuk kalon kurse, në anën tjetër po ia mbajnë izon, si zëra përcjellës Lajçakut, Borrellit dhe Eskobarit me Asociacionin kalon. Kur Ban ki Muni pati dalë me 6 pikat dhe ishte përkrahur nga Sllobodan Samarxhiq, përgjegjës për Kosovën nga qeveria e serbe, pata dalë me një shkrim fort patriotik të titulluar: "6-të pikat e Banit dhe kurvat e Sllobodanit". Kur Albin Kurti doli me 6 pikat për Asociacionin, nuk reagoi fare, ishte një imitim anemik i Banit. Kryeministri Kurti e ka të qartë se nuk ka tjetër rrugë, o të pranojë Zajebnicën, o të shkojë në shtëpi! Prandaj, si zgjidhje e ndërmjetme po e sheh formimin e Asociacioneve tjera që do t'ia hiqnin atributin njënacional që e paska Zajebnica. Tash, boshnjakët kërkojnë Zajebnicë, turqit kërkojnë Zajebnicë, romët do të kërkojnë gjithashtu, ashkalinjt, egjiptasit, goranët, fatosat e Sadrisë, kultivuesit e qeneve të sharrit nga Gora e Dragashit mund të kenë kërkesa të tilla, nostalgjikët jugosllavë dhe pionierët pansllavistë do ta shfrytëzojnë këtë mundësi për afirmim kombëtar dhe shumë grupe dhe grupacione tjera. Albin Kurti mendon se në këtë mënyrë do ta relativizojë themelimin e Zajebnicës duke krijuar asociacione satelite që do të sillëshin rreth tij por e ka shumë gabim. Zajebnica e ka bazën në Bruksel dhe përkrahjen nga Europa dhe Amerika dhe këto zajebnicat e vogla vetëm do të sillen si satelitë rreth Kurtit e, me kalimin e kohës rreth Zajebnicës së Brukselit. Blerja e kohës sa duket të jetë përparësi, del më shumë të jetë pengesë shtesë. Duke i ikur formimit të Asociacionit, si "dhuratë" e kemi propozimin franko-gjerman. Sa më shumë të blejmë kohë, do të kemi edhe

"dhuratë" tjera. Personalisht jam kundër Zajebnicës dhe propozimit franko-gjerman sepse, me kapacitetin apo, më mirë të them me mungesën e kapacitetit, mendoj se Zajebnica, me çfarëdo emri që do të pagëzohet, në të ardhmen e federalizon Kosovën duke e bërë jofunksionale kurse propozimi franko-gjerman nuk ofron asnjë zgjidhje apo zgjidhje vetëm sa e konservon gjendjen për një periudhë 10-vjeçare duke e balsamosur një krijesë, funksionalisht të vdekur shtetërore. Po cila është zgjidhja?! Në planin afatgjatë jam i sigurt se vetëm bashkimi me Shqipërinë është zgjidhje stabilizuese dhe e qëndrueshme e që, sa të jetë një Bosnje siç është tani, bashkimi me Shqipërinë mbetet si ideal dhe idealizim i një dëshire. A jam për ta pushkatuar kryeministrin Kurti për këtë gjendje, nuk jam. Problemet i ka të trashëguara por i ka përdorur apo, më mirë të them i ka keqpërdorur për të ardhur në pushtet. Dhe po vazhdon me qëllim ta mbajë pushtetin. Në çastin kur i hyni pazareve, e pati puna. Si të folni për 6 propozime, për konsiderim të formimit të Asociacion Zajebnicës, keni rënë në pozitën e leximit të filxhanit. Vetëm keni nevojë për një filxhan! Opozita po bënë shumë gabim që Zajebnicën po e përdorë si armë për luftë kundër Kurtit dhe qeverisë Kurti për faktin se mbushja e këtyre armëve është me municion të opozitës (Marrëveshja e Brukselit). Opozita nuk duhet të llogarisë në zgjidhje të parakohshme shkaku se Albin Kurti do të dorëhiqet duk e refuzuar Zajebnicën. Albin Kurti, as nuk dorëhiqet, as nuk shkon në zgjidhje dhe as nuk e lë pushtetin. Me asnjë dhe për asnjë çmim! Opozita mund ta kundërshtojë Zajebnicën dhe propozimin franko-gjerman, ...deri në kafën e radhës në njërin nga ambasadat e fuqishme. Aty dhe atëherë e kuptojnë se Asociacioni si dhe propozimi franko-gjerman, jo që nuk janë të këqija për Kosovën por janë shumë të mira. Albin Kurti këtë e ka kuptuar shumë mirë andaj silltet me aq komoditet dhe shpërfillje ndaj opozitës, prandaj, në masë shumë më të madhe i bënë shkeljet në të gjitha fushat që i kanë bërë qeveritë paraprake dhe nuk ka frikë nga asnjë pasojë. Ndërkombëtarët nuk e qortojnë, çlirimtarët dhe shtetkrijuesit i dërguan në Hagë! E shohim, Lajçaku dhe Borrelli janë shndërruar në hiena kurse ne jemi lodhur shumë, na ka rënë imuniteti! Zoti na ndihmoftë!

Qeveria miraton marrëveshjen për lëvizjen me letërnjoftime në Ballkanin Perëndimor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka miratuar marrëveshjen e lëvizjes me letërnjoftime mes gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor që, pas hyrjes në fuqi, do ta mundësojë lëvizjen pa viza të qytetarëve nga Kosova dhe Bosnjë-Hercegovina. Në mbledhjen e mbajtur të mërkurën, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se kjo marrëveshje është një prej tri marrëveshjeve të arritura në Berlin më 3 nëntor 2022 në kuadër të Procesit të Berlinit. Atëbotë, gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor arritën edhe marrëveshjen për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë dhe atë për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, dentistëve dhe

arkitektëve.

Kurti ka thënë se qeveria do ta procedojë këtë legjislacion në Kuvend për ratifikim. "Ratifikimi i shpejtë i tyre është tregues i përkushtimit dhe angazhimit tonë për bashkëpunim rajonal, marrëdhënie të mira fqinjësore dhe avancim drejt integritimit në Bashkimin Evropian", ka thënë Kurti. Sipas Kurtit, me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje për rajonin, "pas ratifikimit nga dy vendet përkatëse, qytetarët e Kosovës dhe të Bosnjë-Hercegovinës do të lëvizin lirshëm vetëm me letërnjoftime".

Kjo marrëveshje ende nuk është miratuar nga autoritetet në Bosnjë-Hercegovinë.

Bosnjë-Hercegovina nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe qytetarët e të dyja shteteve duhet të pajisen me vizë nëse duan të udhëtojnë në shtetet



përkatëse.

Më 2014 Kosova vendosi masën reciproke sa i përket regjimit të vizave për shtetasit e Bosnjë-Hercegovinës.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe dy nisma. E para për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Transferim të Personave të Dënuar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, nismën e dytë për lidhjen e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Civile ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë. Me këtë marrëveshje Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë bien dakord që t'i thellojnë aspiratat e tyre të bashkëpunimit juridik në çështjet civile me qëllim të

581 specialistëve me vetëfinancim do t'u vazhdohet subvencionimi

Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë, në pikën dy dhe tre të rendit të ditës të propozuar nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, është marrë vendim që të vazhdojë subvencionimi për 591 specialistë me vetëfinancim, prej të cilëve 581 specialistë qytetarë të Republikës së Kosovës, ndërsa janë shtuar dhe 10 specialistë që vijnë nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia. Ministri Vitia ka thënë se kjo

masë është në kuadër të veprimeve që po ndërmerren Ministria e Shëndetësisë me synim të rritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët. "Ne mbesim të angazhuar që kjo masë dhe veprime të tjera të cilat do të ndërmerren në të ardhmen, do të ndikojnë që qytetarëve tanë t'u ofrohen shërbime sa më cilësore", ka thënë ministri Vitia, duke veçuar se kjo mbetet një prej objektivave të qeverisë në kuadër të rritjes së cilësisë dhe përmirësimit të shërbimeve në sektorin publik të shëndetësisë.

Ministrisë së Ekonomisë i barten 720 mijë euro për subvencionimin e energjisë

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë për mbulimin e vlerës së subvencionimit të tarifave të energjisë elektrike për muajin janar 2023. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se bëhet fjalë për 720 mijë euro të cilat barten te ministria që drejton Artane Rizvanolli për t'i

subvencionuar faturat e energjisë. "720 mijë euro në masën 3.7 merren nga Ministria e Financave dhe transferohen te Ministria e Ekonomisë në kategorinë shpenzime, subvencionim dhe transfere. Kjo bëhet për nevojën për zotim të subvencionimit të tarifave të energjisë", ka thënë ministri Murati.

sigurimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe interesave të të dyja vendeve dhe qytetarëve të tyre duke

synuar në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe rritjes së bashkëpunimit të tyre të përgjithshëm.



'Forumi Shqiptar' dorëzon listën për zgjedhje në Tuz, Gjeloshaj: Malësia merr frymë shqip

TUZ, 8 SHKURT - Në një atmosferë fituese dhe festive "Forumi Shqiptar" ka dorëzuar listën në KKZ, ku më 5 mars do të mbahen zgjedhjet lokale për komunën e Tuzit.

Kryetari i komunës së Tuzit, Nik Gjeloshaj, i cili edhe i prinë kësaj liste, ka theksuar se Lista e "bashkimit dhe zhvillimit" është dorëzuar me një numër rekord nënshkrimesh, që dëshmon forcën dhe mbështetjen që ka "Forumi Shqiptar". "Në një

atmosferë fituese e dorëzuar listën e "Forumit Shqiptar", listën e bashkimit dhe zhvillimit. Listën e dorëzuar me një numër rekord nënshkrimesh, që dëshmon forcën dhe mbështetjen që ka "Forumi Shqiptar". Qytetarët e komunës së Tuzit kurrë nuk e kanë pasur më të lehtë se për çfarë të votojnë: për bashkimin e zhvillim! Kur Malësia merr frymë shqip, frymon unitet, frymon zhvillim!", ka shkruar Gjeloshaj në "Facebook".

Miratohet taksa vjetore investuese e Fondit të Kursimeve Pensionale

PRISHTINË, 8 SHKURT - Deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë miratuar taksën vjetore intervistuese prej 0.32-përqindësh dhe taksën operationale prej 0.05-përqindësh për vitin 2023 të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Kryetari i Komisionit për Buxhet, Armend Muja, derisa e ka arsyetuar rekomandimin e komisionit, ka kërkuar nga

deputetët që ta miratojnë. “Buxheti i miratuar nga trusti pensional për aktivitetet operationale për vitin 2023 është 1 milion e 295 mijë euro, apo 31 mijë euro më pak se viti i kaluar. Taksa operationale për vitin 2023 është propozuar të jetë në normën prej 0.05-përqindësh të mjeteve, një ulje kjo nga norma aktuale prej 0.57 të mjeteve. Buxheti i miratuar për aktivitetet

investuese për vitin 2023 pritet të vihet në vlerën prej 8 milionë e 227 mijë euro apo 0.32 për qind të mjeteve”, ka thënë Muja, transmeton KP. Në këtë seancë Kuvendi i Kosovës ka miratuar rekomandimet lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës për vitin 2021.



Mosfaturimi i energjisë në veri, Bislimi fajëson Brukselin

PRISHTINË, 8 SHKURT - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, i ka fajësuar ndërmjetësuesit në Bruksel për moszbatimin e udhërrëfyesit për energjinë, për të cilin Kosova e Serbia u pajtuan në qershor të vitit të kaluar.

Në bazë të kësaj marrëveshje parashihej që të fillojë faturimi i energjisë elektrike në komunat në veri të vendit. Megjithatë, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur.

Në një konferencë për medie të mërkurën, Bislimi ka thënë se Kosova është e vetmja palë e cila plotësisht i ka përbushur obligimet e saj të kësaj marrëveshjeje. “Udhërrëfyesi për energjinë ka paraparë që gjendja me energji të normalizohet deri në tetor dhe për normalizim të situatës me energji është dashur që të zbatohen disa veprime nga qeveria, KEDS-i, KOSTT-i, BE-ja dhe ‘Elektroserversi’. E vetmja palë e cila plotësisht i ka përbushur obligimet e saj është Qeveria e Kosovës e cila e ka licencuar ‘Elektroserversi’-in brenda 48 orëve pas nënshkrimit të udhërrëfyesit dhe e ka pajisur me kodin e identifikimit për energji”, ka thënë Bislimi.

Sipas tij, pika që ka mbetur pa përbushur është dërgimi i të dhënave të plota të



konsumatorëve që është dashur të kryhen nga “Elektroserversi” brenda një afati shtatëditor, por që nuk ka

ndodhur as deri sot. “Janë nënshkruar edhe marrëveshjet mes KOSTT-it dhe ‘Elektroserversi’-it. Ato pika që

kanë mbetur pa përbushur janë dërgimi i të dhënave të plota të konsumatorëve që është dashur të kryhen nga

‘Elektroserversi’ brenda një afati shtatëditor, por që nuk ka ndodhur as deri sot përveç disa të dhënave të falsifikuara që janë dërguar pas 100 ditësh. Nuk është përbushur as pika e nënshkrimit të kontratës kornizë mes KEDS-it dhe ‘Elektroserversi’-it”, ka thënë Bislimi, duke shtuar se, po ashtu, nuk është përbushur as pika 5 e marrëveshjes, e cila kërkon që KEDS-i dhe KOSTT-i të kenë qasje të vazhdueshme dhe të përhershme në stacionin në Vallaq. “Arsyeja pse nuk është finalizuar kjo marrëveshje qëndron në rezistencën e ‘Elektroserversi’-it që të nënshkruajë marrëveshje sipas udhërrëfyesit. Ata insistojnë në respektimin e një marrëveshjeje që gjoja e kanë nënshkruar me KEDS-in në Stamboll, e cila nuk ka të bëjë asgjë me marrëveshjen e Brukselit. Mendoj se një pjesë bukur të madhe të fajit për moszbatimin e marrëveshjes e ka Brukseli”, është shprehur Bislimi.

Më tutje, ai ka thënë se ndërmjetësuesit në Bruksel jo vetëm që e kanë toleruar takimin në Stamboll, por edhe kanë dërguar sinjale të gabueshme tek “Elektroserversi” përmes interpretimeve të neneve të gabueshme të marrëveshjeve që s’kanë të bëjnë asgjë me marrëveshjen e Brukselit.

Kuvendi nuk e miraton raportin vjetor të BQK-së

PRISHTINË, 8 SHKURT - Deputetët e Kuvendit të Kosovës të mërkurën nuk e kanë miratuar raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2021. Ky raport ka marrë vetëm nëntë vota për, ndërsa është kërkuar të ketë edhe diskutim për të në Kuvend. “Në bazë të ligjit ky raport shqyrtohet nga komisioni për buxhet dhe i vjen seancës për informim dhe në seancë pritet të ketë diskutim nga deputetët për gjendjen ekonomike dhe

financiare në vend dhe kaq. Pra i vjen për informim seancës dhe pritet t’i japin vlerësimet mbi këtë raport për gjendjen ekonomike dhe financiare në vend”, ka thënë deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti.

Në anën tjetër, Komisioni për Buxhet ka kërkuar që në kuadër të këtij raporti të jetë edhe guvernatori i BQK-së, por kryesia ka vlerësuar që nuk është e nevojshme dhe i njëjti është hedhur në votim. “66 deputetë morën pjesë në

këtë votim, për ishin nëntë, kundër ishin 57, asnjë abstenim kështu që Kuvendi nuk e miratoi raportin vjetor të Bankës Qendrore për vitin 2021”, ka thënë kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca. Në bazë të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, brenda gjashtë muajve pas mbylljes së vitit financiar e njëjta duhet ta dorëzojë në Kuvend një raport të miratuar nga bordi në lidhje me operationet dhe punën e BQK-së gjatë gjithë vitit.



Sëmundja e Perëndimit: Kriza e kapitalizmit demokratik është serioze por jo fatale



“The Economist”

Për cilindo që është mjaftueshëm i rritur për të kujtuar rënien e komunizmit, historia e kohëve të fundit ka qenë tronditëse. Sepse është zhbërë triumfi i sistemeve politike dhe ekonomike liberale. Kjo gjë ka ndodhur nga gabimet e vendeve të pasura, ngritja e Kinës autoritare, por sidomos për shkak të një humbjeje shqetësuese të besimit tek vetë demokracia në atë që dikur quhej bota e lirë.

Kjo krizë e demokracisë duket disi më pak e tmerrshme sesa një 1 ose 2 vite më parë, dhe kjo falë ndryshimeve politike që kanë ndodhur në SHBA, por edhe hapave të gabuara nga Kina dhe Rusia. Por rreziku nuk ka kaluar, dhe mbetet ende urgjente nevojat për të kuptuar arsyet e tkurrjes së demokracisë.

Martin Wolf është i vendosur që ta analizojë në detaje këtë problem. Një nga figurat më të njohura të gazetarisë së financave, ai ka qenë për dekada të tëra analisti kryesor ekonomik i gazetës Financial Times. Libri i tij më i ri “Kriza e kapitalizmit demokratik”, bazohet në mençurinë e akumuluar gjatë karrierës së tij të shquar.

Në të, Wolf argumenton se pjesa më e madhe e fajit për regresin demokratik të botës në tërësi, lidhet me rekordin e një ecurie ekonomike të keqe. Teza dhe argumentet që ai mbron janë të gjera. Megjithatë në fund ai nuk është plotësisht bindës. Rishikimi i historisë së viteve të fundit nga Wolf do të tronditë edhe njerëzit më të mirë-informuar.

Qeveritë e të gjitha llojeve janë bërë më pak të përgjegjshme në

raport me publikun. Shtetet autoritare janë bërë më shtypëse; disa demokraci të forta janë lëkundur; më të dobëtat janë shembur. Dhe shkak i vetëm nuk është oportunitizmi i udhëheqësve autoritarë.

Sondazhet tregojnë se njerëzit e zakonshëm janë bërë më pak mbështetës të qeverisë përfaqësuese. Mbi 60 për qind e amerikanëve të lindur në vitet 1940, thonë se është “thelbësore” të jetosh në një demokraci. Por sipas një studimi, vetëm pak më shumë se 30 për qind e atyre të lindur në vitet 1980, mendojnë të njëjtën gjë.

Të dhënat e publikuara në vitin 2020, tregojnë se ndër afro 1.9 miliardë banorë që jetojnë në vende demokratike, më pak se çereku i tyre jeton në vende ku shumica e votuesve janë të kënaqur me atë sistem qeverisjeje. Për Wolf, kjo humbje e madhe e besimit – dhe tërheqja nga demokracia që e pasoi – i ka rrënjët në dekadat e dështimeve të politikave ekonomike.

Në pamje të parë, ky duket një argument tepër i arsyeshëm. Që nga fillimi i viteve 1980, pabarazia e të ardhurave dhe pasurisë është rritur në mënyrë dramatike në shumë vende. Për shembull në SHBA, pjesa e të ardhurave nga 1 për qind e popullsisë më të pasur, është gati 2-fishuar, nga rreth 10 në 19 për qind.

Në ekonomitë e pasura, ka qenë zhgënjyese rritja e produktivitetit dhe e të ardhurave të rregulluara nga inflacioni në një familje tipike. Procesi i de-industrializimit i ka zhytur në një depresion të përhershëm ekonomik shumë qytete ku dominon shtresa

punëtore.

Tronditja që shkaktoi kriza financiare globale e viteve 2007-2009, e shndërroi pakënaqësinë e akumuluar në një zemërim të madh kundër elitave qeverisëse dhe në një humbje të besimit tek sistemi. Martin Wolf nuk e mohan se racizmi, migrimi dhe ankthet kulturore e nxitën zhgënjimin e njerëzve ndaj demokracisë.

Por ai mendon se faktorë të tillë, mund të ndikojnë tek zgjedhjet vetëm në një klimë besimi të dobësuar ndaj elitave, të ushqyer nga dështimet ekonomike. Një dinamikë e ngjashme, thotë ai, me atë që ngjiti dikur në pushtet nazistët në Gjermani. Narrativa e librit se si gjërat kanë shkuar keq ekonomikisht është e plotë, dhe rekomandimet e tij mbi politikën janë të detajuara dhe shumë të arsyeshme.

Megjithëse Wolf është i gatshëm të pranojë disa sugjerime jo shumë radikale – ai mendon se ia vlen të shikohet një garanci e punës – ai pranon se nuk është koha për revolucion. Ajo që nevojitet, shkruan ai në libër, është ndryshimi në rritje: mbështetja e sistemit të sigurisë sociale, rritja e konkurrencës dhe ruajtja e tregtisë globale.

Në përgjithësi, libri dominohet nga një frymë ngushëlluese. Ai i siguron lexuesit se ajo që ka shkuar keq dihet, dhe se gjithçka që nevojitet për të ndrequr situatën është pak më shumë teknokraci kompetente. Por, sado e dëshirueshme që është jetë komoditeti – dhe për këtë arsye një teknokraci kompetente – është e vështirë të zbehet ndjenja se demokracitë të mëdha të botës u ka ndodhur diçka më e thellë.

Nëse thelbi i krizës janë problemet ekonomike dhe dështimi i elitës, atëherë pse ato nuk ndodhën më shpejt? Vitet 1970 ishin një epokë e inflacionit galopant, recesioneve të mëdha, kriminalitetit në rritje dhe e plagëve të tjera sociale, që sollën kolaps të cilat e shkatërruan industrinë e fillimit të viteve 1980.

Megjithatë demokracia dukej e sigurt. Kriza globale financiare ishte vërtet tronditëse, dhe përqindjet e votave të partive populiste u rritën qartë menjëherë pas saj. Por lidhjet midis dhimbjes ekonomike dhe populizmit, dhe midis populizmit dhe rënies demokratike, nuk janë aq të thjeshta dhe automatike.

Greqia vuajti shumë gjatë viteve 2010, por pjesa e votave të partisë fashiste Agimi i Artë arriti kulmin me vetëm 7 për qind. Kur u ngjiten në pushtet, populistët grekë të Syrizaqeverisës njëlloj si të majtët normalë evropianë. Ose merrni parasysh një tjetër kundër-fakt: nëse Bernie Sanders, një tjetër populist i të majtës, do të kishte arritur të bëhej president i Amerikës në vitin 2017, nuk ka asnjë dyshim që ai do të kishte bërë shumë gabime.

Por duket e pamundur që ai të kërcënonte institucionet demokratike të vendit. Shumë qartësues është edhe një krahasim i vështirësive aktuale me ato të gjysmës së parë të shekullit XX0-të. Gjermania humbi një luftë, miliona njerëz, një perandori dhe monedhën e saj kombëtare.

Në kulmin e Depresionit, një e katërta e fuqisë së saj punëtore ishte e papunë. Dekadat e fundit, bota e pasur ka përjetuar disa recesione të dhimbshme. Por ajo i

ka përballuar ato me politika makroekonomike dhe me rrjete të sigurisë sociale shumë më të mira se ato të viteve 1930.

Pabarazia nuk është rritur shumë që nga viti 2000. Përveç disa vendeve, të ardhurat mesatare janë rritur, qoftë edhe në mënyrë të ngadaltë. Është e vërtetë që ky fillim-shekulli ka qenë i trazuar dhe qeveritë kanë gabuar. Por pavarësisht kësaj, kur Donald Trump u zgjodh president në nëntor 2016, shkalla e papunësisë në Amerikë ishte vetëm 4.7 për qind.

Nëse demokraci të tilla të konsoliduara janë në rrezik, atëherë është e sigurt se forca të tjera gërryese duhet të kenë komplotuar me tendencat ekonomike për t'i bërë ato shumë problematike. Pyetja se cilat janë ato forca po e përndjekin jo pak botën demokratike.

Ju mund të përmendni vetëkënaqësinë e nxitur nga aftësia e internetit për të përhapur ide të shëmtuara, apo mënyrën përmes së cilës globalizimi ka forcuar ndonjëherë lidhjet midis vendeve duke gërryer lidhjet brenda tyre. Sipas disa analizave, fajin e ka vetë progresi: zbrazëtia shpirtërore e krijuar pas plotësisht të nevojave materiale (dhe mposhtjes së ideologjive rivale) i ka shtyrë disa njerëz në Perëndim të kërkojnë në vende të rrezikshme kuptimin dhe komunitetin.

Aty ku Wolf ka padyshim të drejtë, është vlerësimi i tij pesimist se demokracitë, madje edhe ato më të vjetra dhe krenare, mund të rrëzohen një ditë. Dhe parandalimi i kësaj kërkon një mënyrë menduarit përtej zonës së rehatisë. / The Economist – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Vdes legjenda e Kroacisë dhe e Prishtinës

Bota e sportit ka mbetur edhe pa një legjendë. Ish-trajneri i famshëm i skuadrës së Prishtinës, Miroslav Qiro Blazheviq, ka ndërruar jetë në moshën 87-vjeçare. Figura e Qiros është vlerësuar maksimalisht në Kosovë. Ministri i MKRS-së, Hajrulla Çeku, ka thënë se Qiro gëzonte respekt në gjithë Kosovën, derisa kontributi i tij do të mbetet gjithmonë në kujtesën e dashamirëve të këtij sporti

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 SHKURT - Legjenda e futbollit kroat dhe ish-trajneri i Prishtinës, Miroslav Qiro Blazheviq, ka ndërruar jetë të mërkurën në mëngjes. Ai luftoi me kancerin për shumë vjet. Ai u diagnostikua për herë të parë me këtë sëmundje në vitin 2011. Legjendari Qiro e mundi dy herë këtë sëmundje, por dështoi herën e tretë. Blazheviq pati një karrierë të suksesshme ku luajti për ekipe si Dinamo e Zagrebit, Lokomotiva, Sarajeva, Rijeka e Sioni. Karrierën e trajnerit e ka nisur në Vevej, kurse përveç Prishtinës ka drejtuar edhe Sionin në Zvicër, Rijekën, Dinamo Zagrebin e Grasshoperin. Ai ishte edhe trajneri i Nantes e PAOK-ut. Në vitin 1998 ai udhëhoqi Kroacinë drejt një medalje të madhe bronzi në Kampionatin Botëror

në Francë. Më vonë ai drejtoi Iranin, Osijekun, Hajdukun, ndërsa nga viti 2008 deri në vitin 2009 ishte trajner i Bosnjë-Hercegovinës. Qiro ishte edhe trajner i Prishtinës në vitin 1986, në kohën kur klubi i kryeqytetit të Kosovës luante në ligën e parë federative të ish-Jugosllavisë. Ish-skuadra e tij, Prishtina, e ka vlerësuar lart legjendën kroate, emri i të cilit tashmë është shkruar me shkronja të arta në klubin më të madh në Kosovë. "Ai erdhi te Prishtina si shpëtimtar dhe si i tillë u largua derisa e drejtoi gjeneratën e artë të Prishtinës. Blazheviq e udhëhoqi me shumë pasion e dashuri Prishtinën në vitet e vështira të popullit tonë nën okupim duke u dhënë zemër e bashkuar të gjithë shqiptarët përreth klubit dhe stadiumit të qytetit. Emri i tij tashmë është shkruar me shkronja të arta në klubin tonë", thuhet në



postimin e FC Prishtina. Pas vdekjes së Qiro Blazheviqit ka reaguar edhe Federata e Futbollit e Kosovës. FFK-ja e ka kujtuar atë si një person shumë të dashur për komunitetin tonë, pasi ai ishte në krye të Prishtinës në vitet 1985/86. "Ka ndërruar jetë trajneri legjendar kroat Miroslav Qiro Blazheviq. Ai vdiq pas një sëmundjeje të gjatë dhe të rëndë në Zagreb. Qiro ishte mjaft i dashur për komunitetin e futbollit në Kosovë, ngase drejtoi me shumë pasion e sukses gjeneratën e artë të Prishtinës

në elitën e futbollit të ish-federatës në vitet 1985/86. Qiro vazhdimisht kishte shprehur simpatinë e tij për Kosovën, teksa periudhën e kaluar te Prishtina e vlerësonte si të veçantë për shkak të dashurisë së madhe që i ofruan futbollistët, drejtuesit dhe tifozët e klubit", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës. Për vdekjen e Blazheviqit ka reaguar edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, i cili ka thënë se komunitetin sportiv dhe gjithë qytetarët e Kosovës i ka

pikëlluar shumë lajmi për ikjen në amshim të legjendës Blazheviq. "Në kohën kur me shumë vullnet e profesionalizëm drejtonte gjeneratën e artë të futbollit të kryeqytetit, 1985/86, stadiumi thyente rekorde rajonale për nga numri i tifozëve. Teksa gëzonte respekt jo vetëm për futbollistët, por për gjithë Kosovën, kontributi i tij do të mbetet gjithmonë në kujtesën e dashamirëve të këtij sporti. Ngushëllimet më të sinqerta familjarëve, miqve dhe tërë komunitetit të futbollit kosovar e kroat", ka thënë Çeku.

Giresse: Lojtarët tani duan ta mbrojnë vendin e tyre për shkak të historisë që ka Kosova

PRISHTINË, 8 SHKURT - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Alain Giresse, në një intervistë për "100 % Girondins sur France Bleu Gironde" ka folur për ekipin e Kosovës, për lojtarët dhe për ambicjet që i ka me "dardanët". Fillimisht ai tregoi për fillimin e "flirtimit" me Kosovën që kur ishte trajner i Senegalit. "E kam njohur këtë vend që kur isha ftuar për një vizitë, 10 vjet më parë. Kur isha selektor i Senegalit e propozova një miqësore me

Kosovën, edhe para pranimit të Kosovës në FIFA", ka deklaruar fillimisht ish-futbollisti i njohur francez. "Ne jemi në gjendje të mirë dhe gjithçka po shkon mirë te Kosova. Të gjithë janë të gatshëm dhe në dispozicion për të punuar. Çdo gjë që e kërkoj, e kam atë. Mund të them se lojtarët janë vërtet të vlerësuar në nivelin human dhe mjaft të respektueshëm për rolin që e kanë në këtë ekip", ka vazhduar Giresse. Ai ka zbuluar më shumë rreth lojtarëve të Kosovës, ndërsa ka folur edhe për objektivat që i ka



me ekipin. "Ne e kemi Zhegrovën apo Zenelin të cilët luajnë në Francë. Nuk kam probleme për ta menaxhuar këtë ekip. Ata përmbahen dhe

dëgjojnë. Ekziston një shpirt i mirë dhe pozitiv aty. Lojtarët janë të shpërndarë nëpër Evropë, asnjëri prej tyre nuk luan në vendin e tij", ka shpjeguar Giresse. "Ka lojtarë si kapiteni jonë i cili po shkëlqen në Napoli (Amir Rrahmani), i cili e ka një dimension të gjerë. Ka edhe lojtarë të tjerë që luajnë në Spanjë, e kemi një nivel të kënaqshëm. E mbyllëm Ligën e Kombeve mirë. Tash do të shkojmë ta sfidojmë veten në betejën e re", ka shtuar tutje francezi. "Kosova është pranuar në FIFA para gjashtë

vjetësh, është një 'firmë e re', e ka një Federatë të re, e cila është duke u strukturuar, në kushte pune nuk ka asgjë për t'u ankuar. Gjërat janë të organizuara mirë, çdo gjë është e planifikuar dhe kushtet janë mjaft të mira. Dhe, lojtarët që janë në një cikël profesional tani duan ta mbrojnë vendin e tyre për shkak të historisë së këtij vendi", ka përfunduar Giresse. Kosova do t'i nisë kualifikimet e "Euro 2024" në mars të këtij viti dhe do t'i mbyllë ato në muajin nëntor.

Rritet vlera e koeficientit për federatat sportive

PRISHTINË, 8 SHKURT - Mbështetja financiare për federatat e sportit ka shënuar rritje rekorde për vitin 2023, njofton Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Koeficienti i pikës për federatat e kategorisë A është rritur në 2 600 euro, ndërsa për kategorinë B do të jetë 1 800

euro. Federatat e kategorisë C janë vlerësuar me koeficient të pikës prej 1 500 eurosh, ndërsa për kategorinë D është rritur në 1 300 euro. Buxheti i rritur nënkupton më shumë aktivitete fizike dhe më shumë cilësi në sportin vendor. Zëvendësministrja e MKRS-së, Daulina Osmani, ka thënë

se mbështetja direkte e federatave sportive është rritur rreth 128 %. "Për vetëm dy vjet mbështetja direkte e federatave sportive është rritur rreth 128 % apo 2.5 milionë euro më shumë se në vitin 2021. Vlera e koeficientit të kategorisë D tejkalon vlerën e koeficientit të sporteve

individuale të kategorisë A në vitin 2021. Financimi i sportit përmes kategorizimit është vetëm njëri kanal i financimit direkt nga MKRS-ja. Projektet e veçanta, sponsorizimi, thirrjet publike, shpërblimet e përhershme, shpërblimet për rezultate dhe bursat olimpikë janë disa nga format e tjera të



financimit të komunitetit sportiv në vend", ka shkruar Osmani në "Facebook".

LeBron bëhet shënuesi më i mirë në histori të NBA-së

LOS ANXHELOS, 8 SHKURT - LeBron Jamesi e ka futur emrin e tij në mesin e legjendave të basketbollit. Ylli i Los Angeles Lakersit u bë koshashënuesi më i mirë në histori të NBA-s pasi i realizoi 38 pikë në humbjen e ekipit të tij 130:133 nga Oklahoma City. James kishte nevojë për 36

pikë për ta thyer rekordin e legjendës tjetër të këtij sporti, Kareem Abdul-Jabbar, të regjistruar gati katër dekada më parë. E James, dy pikët me të cilat e theu rekordin absolut, i shënoi në sekondat e fundit, me ç'rast e ngriti në këmbë publikun e pranishëm në palestër. James


arriti në kuotën e 38.390 pikëve në një sezon të rregullt në NBA, kurse Abdul-Jabbar në karrierën e tij të lavdishme i kishte realizuar 38.387. James u pa mjaft i emocionuar pasi u bë koshashënuesi më i mirë në histori të NBA-së. "Jam mjaft i nderuar dhe krenar që e gjej

veten përkrah një legjendë si Abdul-Jabbar. Dua t'i falënderoj të gjithë ata që ishin pjesë e këtij rrugëtimi 20-vjeçar me mua", u shpreh James, i cili shtoi se kështu po i realizohet një ëndërr e kamotshme. James është përgëzuar edhe nga Karrem Abdul-Jabbar për këtë arritje të re.



Lahm: PSG-ja ta futë frikën në letër, shpresoj që Bayerni të jetë në ditën më të mirë

MUNCHEN, 8 SHKURT - Diferenca e ngushtë në tabelën e Bundesligës pas 19 javësh e ka çuditur Philipp Lahm, aq sa të deklarojë se kampionati ka marrë tjetër perceptim nëse u referohemi viteve të fundit. Madje ish-kapiteni i Bayernit nuk ka anashkaluar as duelin e ethshëm në Ligën e Kampionëve përballë PSG-së, i cili, sipas tij, do të jetë shumë i vështirë. "Liga vendëse ka pësuar transformim në sezonin aktual dhe renditja shërben si matësi më i mirë. Konkurrenca nuk përfshin vetëm Bayernin me Dortmundin, ekipe që i kanë dhënë ritëm futbollit gjerman në vitet e fundit, sigurisht me mbizotërimin e bavarezëve. Unioni dhe Leipzigu ndodhen aty, ashtu si Frankfurti me lojtarë tepër cilësorë. Gjithsesi u qëndroj besnik mendimeve se Bayerni do të ngrejë sërish trofeun pas 34 raundesh. Nga krahu tjetër ky fenomen mund të ndikojë pozitivisht edhe në Ligën e Kampionëve", ka deklaruar shtatshkurtri gjerman. "Yjet e



Parisit ta fusin frikën në letër, por fusha do të japë panoramë më të qartë. Mjafton për ta parë përbërjen e tyre me emra të rëndë si Messi, Neymar apo Mbappe për të kuptuar se kundër kujt po luan dhe çfarë qëllimi ke në kokë. Të shpresojmë se djemtë e Nagelsmanit do të jenë në ditën më të mirë ndaj një skuadre të nivelit botëror në çdo repart. Besoj se episode të caktuara do të

vendosin verdiktet finale se kush do të shkojë në fazën tjetër", përfundoi drejtori i turneut "Euro 2024" për Agjencinë e Shtypit Gjerman. Akti i parë mes dy ekipeve në fjalë në kompeticionin më të rëndësishëm në spektrin e klubeve në rruzullin tokësor do të zhvillohet me 14 shkurt, ndërsa ai i kthimit më 8 mars, ku tempulli i "Allianz Arena"-s do ta përcaktojë çerekfinalistin.

Fitojnë Denveri, Memphisi dhe Phoenixi

DENVER, 8 SHKURT - Skuadra e Denverit vijon të dominojë në Konferencën e Perëndimit dhe barazon rekordin e Bostonit, me 38 fitore deri më tani këtë sezon. Nuggetsit fitoi me rezultat 146-112 ndaj Minnesotas, ndeshje ku Nikola Jokiqi realizoi një tjetër "triple double", me 20 pikë, 12 rebounde e 16 asistime. Shënuesit më të mirë për Denverin ishin Porter me 30 pikë e Gordoni me 24. Për Lakersat nuk mjaftuan 38 pikët e LeBron Jamesit (vendosi rekordin e shënuesit më të mirë në historinë e



NBA-së), për ta mundur Oklahomën, që fitoi me rezultat 133-130. Për miqtë u dallua Alexander Shai me 30 pikë. Fitoi edhe ekipi i Memphisit, që mundi me rezultat 104-89 Chicagon, ndeshje ku u dallua Ja Morant, autor i 34 pikëve. Vijon kriza e Brooklynit, që u mund me rezultat 116-112 në

fushën e tij nga Phoenixi. Për Suns-in u dallua Ayton me 35 pikë e 15 rebounde, duke i bërë të pavlefshme 43 pikët e Cam Thomas për Netsin. New Yorku, falë 25 pikëve të Brunsonit, mundi me shifrat 102-98 Orlandon, ndërsa New Orleansit triumfoi 116-107 ndaj Atlantas (Ingram 30 pikë).

REZULTATET

Orlando - New York	98-102
Brooklyn - Phoenix	112-116
New Orleans - Atlanta	116-107
Memphis - Chicago	104-89
Denver - Minnesota	146-112
Lakers - Oklahoma	130-133

SHKURT

Messi dhuron 3.5 milionë euro për të prekurit nga tërmeti në Turqi dhe Siri

Tërmetet tragjike në Turqi dhe Siri kanë bërë bashkë të gjithë botën pasi qindra persona kanë kontribuar në mënyrë financiare. Një ndër ta është edhe sulmuesi Lionel Messi. Sipas raportimeve nga një sërë mediesh në Turqi, ylli argjentinas ka shpërndarë ndihma humanitare në vlerë 3.5 milionë euro. Ai i ka kërkuar fondacionit të tij që të dërgojë ndihma në vendin e tërmetit. "Fondacioni 'Leo Mesi'" është një fondacion familjar që kujdeset për shëndetin dhe edukimin e fëmijëve nëpër botë dhe vëllai i tij i madh i Leos, Matias organizon aktivitete në partneritet me UNICEF-in.

Presidenti i Napolit: Osimhen nuk është në shitje

Manchester Unitedi dhe PSG-ja janë të gatshëm të paraqesin një ofertë me tri shifra, por Victor Osimhen nuk është në shitje në fund të këtij sezoni, për këtë garanton presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis. "Osimhen nuk është në shitje. Lojtarët tanë janë të shumëkërkuar, por ne nuk jemi të detyruar të shesim, nuk dua të shes askënd pasi klubi ynë nuk ka borxhe", u shpreh De Laurentiis për "Bild". Osimhen ka një kontratë të vlefshme deri më 2025.

Tedesco emërohet trajner i Belgjikës

Trashëgimtari i Roberto Martinezit, i cili u largua nga drejtimi i Belgjikës, pas dështimit në Kupën e Botës "Katar 2022", është Domenico Tedesco. Trajneri 37-vjeçar, i shkarkuar nga Leipzigu në shtator, do ta drejtojë De Bruynen dhe shokët e tij deri në Kampionatin Evropian të vitit 2024. Tedesco ka drejtuar në karrierën e tij 251 ndeshje dhe ka arritur të marrë 132 fitore, 46 barazime dhe 73 humbje.

Leclerc synon titullin në Formulën 1

Piloti monogask i Ferrari, Charles Leclerc, përgatitet për sezonin e ri të Formulës 1. Ai shprehet se pret një makinë më të fortë se ajo e sezonit të kaluar, ndërkohë që për të nuk do të jetë e vështirë përshtatja me njëvendëshen e re. "Vjet, pilotët u detyruan ta ndryshojnë stilin e pilotimit për t'iu përshtatur rregullave të reja. Këtë vit do të jetë më e lehtë për ne. Vjet arrita nëntë 'pole position' dhe shumë pak prej tyre u përkthyen në fitore në garë. Këtë vit do të doja të ishte e kundërta, të fitoja më shumë të dielën, duke mos humbur edhe ritmin e mirë që kemi pasur të shtunën në provat zyrtare. Sa më shpejt të përshtatemi me makinën e re aq më të lehtë do ta kemi", ka thënë Leclerc. "Testet e para do të jenë një tregues i mirë, duke parë gjendjen e makinës së re dhe mundësinë se ku do të përmirësohemi. Nëse do ta kemi makinën nën kontroll, atëherë do të jetë më e lehtë dhe do të duelojmë për fitore. Mendoj se ka ardhur koha për ta bërë hapin e madh", ka shtuar Charles Leclerc.

Ekipi i mundjes kthehet në Kosovë


PRISHTINË, 8 SHKURT - Ekipi i të rinjve i mundjes i ka shpëtuar tërmetit në Turqi. Sportistët tashmë janë kthyer në Kosovë, ka njoftuar Komiteti

Olimpik i Kosovës. "Ekipi ynë ndodhej në qytetin Kahramanmarash, ku ndodhi tërmeti i fuqishëm që goditi Turqinë", thuhet në

njoftimin e KOK-ut. Gjashtë anëtarët e ekipit po merrnin pjesë në turneun "12 February". Fatmirësisht, kanë shpëtuar pa lëndime.

Tërmeti i shkallës 7.8 ballë ka goditur Turqinë dhe Sirinë orët e para të së hënës. Si pasojë e këtij tërmeti kanë vdekur mbi 10 mijë persona.





Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ibrahim Jashari shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Adil Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Jonida Lulzim Haxhiajdini nga Peja shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të edukimit pran universitetit "Fehmi Agani" Gjakovë me nr. 408

- Liki&Abi SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811477589.

- Shahin Arifi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT : Arkitekt Sinani (Ish Boris Kidric).

- Blerta Gjeloši shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore " Migjeni"

- Lutfi Hajra shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani" (ish Boris Kidric).

- Xhevdet Brahimi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Jusuf Rexha".

- Mentor Bunjkau B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb:81036429.

- Famous Club sh.p.k shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810110114.

- Arbnor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e maturës te SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Berat Bajraktari shpalle te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III,IV dhe diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Shefki Azemi shpalle te pavlefshme certifikatën e lëshuar nga DTC me numër 366/18 Kursi Hidroinstalim-ujësjellës.

- Rafet Durmishi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT" Arkitekt Sinani".

- Naser Hasani B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e TVSH-se e numër 330043737.

- Mentor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e SHMLM" Dr Xheladin Deda".

- Antigone Beka shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme " Dr. Xheladin Deda".

- Vëllezërit Hysa SH.P.K. Dega Kosove shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 811324409.

- Sh.P.K Broja Market shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810359209.

- Eskont L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810140335.

- Granit Sylejmani shpall të pavlefshme diplomën e Gjiminazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

- Ora Travel SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811467168.

- Gabriell Prenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjiminazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Nora Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl I te sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Jozef Tunprenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu "Don Shtjefen Kurti" Novosell e Epërme nga kl.I-V dhe VI-IX

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

